

KONTRATË SHIT-BLERJE (KUOTE)

Sot më datë 19.03.2024, palët kontraktore, me vullnet të lirë dhe të plotë, lidhin këtë kontratë shitblerje me kushtet e mëposhtme:

SHITËSI: Z. Miken Dervishi, atësia Piro, lindur më 16.07.1979, në Tiranë dhe banues në Tiranë, në adresën: Sheshi "Gjenerali Jozef San Martin", Nd.3, H.10, Ap. 23, identifikuar me letërnjoftimin ID me nr. 035086937, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, *(në vijim referuar si "Shitësi")*;

BLERËSI: Shoqëria "Aksent L&BC" shpk, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L91406014L, me seli në adresën: Rruga "Brigada 8", Ndërtesa 23, kati 2, Ap. nr.2, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori z. Endri Puka, atësia Xhorxhi, lindur më 19.10.1976, në Fier dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftimin ID me nr. 036113955, *(në vijim referuar si "Blerësi")*.

Kushte të përgjithshme

- A. Shoqëria "Parisol" shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS M22507403B dhe me seli në adresën: Fier, Njësia Administrative Topojë, Fshati Grykë, Pasuria 558, Zona Kadastrale 3358 *(më tej referuar si "Parisol")*.
Kjo shoqëri përbëhet nga 2 (dy) ortakë, të cilët janë pjesëmarrës në kapitalin e kësaj shoqërie si më poshtë:
1. Z. Miken Dervishi, i cili zotëron, një kuotë që përfaqëson 90% të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk.
 2. Shoqëria "Albanian General Electricity" sha, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L41706021V, e cila zotëron një kuotë që përfaqëson 10% të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk.
- B. Shitësi deklaron se zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk, e barasvlefshme me 90% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 900 Lekë (nëntëqind).
- C. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit, dhe Blerësi dëshiron të blejë nga shitësi, 20% të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk.
- D. Blerësi ka kryer *due diligence* dhe është njohur me ortakët e shoqërisë "Parisol" shpk, me çdo të dhënë dhe tregues të aktivitetit tregtar të shoqërisë, të gjendjes ekonomike, financiare dhe juridike të saj, të të drejtave dhe detyrimeve civile, administrative dhe tatimore, aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.
- E. Blerësi deklaron se është në dijeni të plotë të Kontratave dhe Marrëveshjeve që shoqëria "Parisol" shpk, ka nënshkruar deri në datën e lidhjes së kësaj kontrate si dhe gjithë detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga këto kontrata, marrëveshje apo aktiviteti i shoqërisë.

- F.** Blerësi deklaron se i pranon dhe nuk ka asnjë kundërshtim në lidhje me sa më sipër.
- G.** Përfundimisht, pas nënshkrimit të kësaj Kontrate Shitblerje, shoqëria "Parisol" shpk do të përbëhet nga 3 (tre) ortakë, secili me nga një kuotë, si më poshtë vijon:
1. Z. Miken Dervishi, do të zotërojë një kuotë, e cila përfaqëson 70% të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk, me vlerë 700 lekë (shtatëqind).
 2. Shoqëria "Albanian General Electricity" sha, zotëron një kuotë, e cila përfaqëson 10% të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk, me vlerë 100 lekë (njëqind).
 3. Shoqëria "Aksent L&BC" shpk, do të zotërojë një kuotë, e cila përfaqëson 20% të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk, me vlerë 200 lekë (dyqind).
- H.** Në përputhje me neni 14 dhe 15 të Statutit të shoqërisë "Parisol" shpk, Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Palët, me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të pacënuar, vendosin të lidhin këtë Kontratë Shitblerje (në vijim referuar si "Kontrata"), me kushtet si më poshtë vijon:

NENI 1

Objekti

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate, Shitësi i kalon Blerësit titullin e pronësisë mbi 20% (njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me këtë kapital, ndjekin këtë të fundit dhe kalojnë gjithashtu në favor të Blerësit.

NENI 2

Çmimi dhe Pagesa

- 2.1 Çmimi i shitjes, që Blerësi do t'i paguajë Shitësit për shitjen e 20% të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk është 223,112 Lekë (dyqind e njëzetë e tre mijë e njëqind e dymbëdhjetë).
- 2.2 Ky çmim do të paguhet nga Blerësi, brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 2.3 Çmimi do të paguhet nga Blerësi në favor të Shitësit nëpërmjet transfertës bankare në një nga llogaritë bankare të këtij të fundit.

NENI 3

Kalimi i titullit të pronësisë

- 3.1 Titulli i pronësisë së 20% (njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk, nga Shitësi tek Blerësi kalon në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate Shitblerje.

NENI 4

Efektet e shitjes

- 4.1 Palët bien dakord se pas nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe kalimit të titullit të pronësisë nga Shitësi tek Blerësi, Shoqëria do të ketë këtë strukturë ortakërie:
- 4.1.1 Z. Miken Dervishi, do të zotërojë një kuotë, e cila përfaqëson 70% të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk, me vlerë 700 lekë (shtatëqind);
 - 4.1.2 Shoqëria "Albanian General Electricity" sha, zotëron një kuotë, e cila përfaqëson 10% të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk, me vlerë 100 lekë (njëqind);
 - 4.1.3 Shoqëria "Aksent L&BC" shpk, do të zotërojë një kuotë, e cila përfaqëson 20% të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk, me vlerë 200 lekë (dyqind).

NENI 5

Garancitë e Palëve

5.1 Shitësi garanton Blerësin se:

- 5.1.1. Pjesët e kapitalit që ai zotëron në shoqëri dhe që janë objekt i shitblerjes sipas kësaj kontrate nuk janë subjekt barrësimi, ndalimi shitje, të drejte parablerje të pa ofruar, garancie bankare, apo e ndonjë mjeti tjetër i cili siguron ekzekutimin e detyrimeve.
- 5.1.2. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur shitjen e pjesëve që ai zotëron në kapital dhe që janë objekt i kësaj kontrate dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik.

5.2. Blerësi garanton Shitësin se:

- 5.2.1. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur blerjen e 20% të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj.

NENI 6

Konfidencialiteti

6.1 Palët bien dakord që kjo Kontratë dhe çdo negociim parakontraktor do të trajtohet në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe se nuk do të transmetojë asnjë të dhënë apo informacion lidhur me marrëdhëniet tregtare, financiare apo ligjore të njëra-tjetrës, si dhe se nuk do të bëjnë asnjë deklaratë lidhur me ekzistencën, objektin apo parashikimet e kësaj Kontrate.

6.2 Palët përjashtohen nga detyrimi i ruajtjes së konfidencialitetit në rast se:

- Pala tjetër ka dhënë pëlqimin për transmetimin e të dhënave;
- Transmetimi bëhet në kuadër të përmbushjes së një detyrimi;
- Nevojitet për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik;
- Këto të dhëna janë bërë publike nga vetë pala tjetër dhe ndodhen në domain-in publik dhe/ose janë të aksesueshme nga persona të tretë;
- Këto të dhëna janë bërë publike ose i janë bërë të njohura palës që transmeton të dhënat nga persona të tretë.

NENI 7

Komunikimi ndërmjet palëve

7.1 Të gjitha komunikimet ndërmjet palëve, si dhe kërkesat që ato kanë ndaj njëra tjetrës, do të kryhen në mënyrë shkresore në adresat e përcaktuara nga palët në pjesën e gjeneraliteteve të tyre.

7.2 Në rast se personat dhe/ose adresat e mësipërme pësojnë ndryshime, Pala që i pëson ato ka detyrimin të njoftojë palën tjetër brenda 24 orësh nga momenti i ndryshimit. Në rast të kundërt, çdo komunikim në adresën e mëparshme do të konsiderohet i vlefshëm edhe pse mund të mos jetë marrë nga ana e Palës, që ka ndryshuar personin e kontaktit dhe/ose adresën.

NENI 8

Ndryshimet e kontratës

8.1 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate bëhet me pëlqimin e përbashkët të palëve dhe do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se bëhet me shkrim dhe në nënshkruhet nga të gjitha palët në këtë Kontratë.

NENI 9

Interpretimi i kontratës

- 9.1 Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.
- 9.2 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj kontrate. Kushti i pavlefshëm në këtë rast do të zëvendësohet me një të vlefshëm, i cili do t'i përkojë sa më shumë të jetë i mundur qëllimeve të palëve.
- 9.3 Ligji i zbatueshëm për interpretimin e kësaj Kontrate do të jetë legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Palëve lidhur me këtë Kontratë, palët duhet të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.
- 10.2 Nëse nuk arrihet një marrëveshje, Kontrata do të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 11

Të tjera

- 11.1 Bashkëlidhur dhe pjesë integrale e kësaj Kontrate janë:
- 11.1.1 Kopje e letërnjoftimit ID të palëve nënshkruese;
 - 11.1.2 Ekstrakt nga regjistri tregtar i Blerësit;
 - 11.1.3 Ekstrakt nga regjistri tregtar i shoqërisë “Parisol” shpk;
 - 11.1.4 Vendim datë 19/03/2024 i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “Parisol” shpk;
 - 11.1.5 Vendim datë 19/03/2024 i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “Aksent L&BC” shpk.
- 11.2 Kjo kontratë është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.
- 11.3 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

PALËT

SHITËSI
Z. Miken DERVISHI

MIKEN DERVISHI
(emër, mbiemër, nënshkrim)



BLERËS
Shoqëria “Aksent L&BC” shpk
Administrator
Z. Endri PUKA

(emër, mbiemër, nënshkrim)



VENDIM NR. 3
DATE 19/03/2024
I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË “AKSENT L&BC” SHPK

Sot, më date 19.03.2024, ora 09:00, në selinë e shoqërisë “Aksent L&BC” shpk, në adresën: Tiranë, Rruga “Brigada 8”, Ndërtesa 23, kati 2, Ap. nr.2, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “Aksent L&BC” shpk, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Nuis L91406014L. Në këtë mbledhje janë të pranishëm personalisht ortakët e shoqërisë, si në vijim:

- Z. Endri Puka, i cili zotëron 75 % të kapitalit të shoqërisë “Aksent L&BC” shpk;
- Z. Ened Janina, i cili zotëron 17,65 % të kapitalit të shoqërisë “Aksent L&BC” shpk;
- Z. Ted Tase, i cili zotëron 7,35 % të kapitalit të shoqërisë “Aksent L&BC” shpk.

Në bazë të nenit 86 dhe 87 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, mbledhja konsiderohet e rregullt.

Rendi i ditës në mbledhjen e sotme është si më poshtë:

1. Miratimi i blerjes nga ana e shoqërisë “Aksent L&BC” shpk me NUIS L91406014L, të 20% të kapitalit të shoqërisë “Parisol” shpk, që zotërohet nga z. Miken Dervishi, me çmimin prej 223,112 Lekë (*dyqind e njëzetë e tre mijë e njëqind e dymbëdhjetë*).
2. Autorizimi i Administratorit të shoqërisë “Aksent L&BC” shpk, z. Endri Puka, të nënshkruajë kontratën e shit-blerjes së kuotave.
3. Të ndryshme.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, pasi diskutoi çështjet e rendit të ditës, me unanimitet:

VENDOSI:

1. Miratimin e blerjes nga ana e shoqërisë “Aksent L&BC” shpk me NUIS L91406014L, të 20% të kapitalit të shoqërisë “Parisol” shpk, që zotërohet nga z. Miken Dervishi, me çmimin prej 223,112 Lekë (*dyqind e njëzetë e tre mijë e njëqind e dymbëdhjetë*).
2. Autorizimi i Administratorit të shoqërisë “Aksent L&BC” shpk, z. Endri Puka, të nënshkruajë kontratën e shit-blerjes së kuotave.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE
SHOQËRIA “AKSENT L&BC” SHPK
ORTAKËT

Z. Endri PUKA

Z. Ted Tase

Z. Ened JANINA

Endri Puka

Ted Tase

Ened Janina



SHOQËRIA "PARISOL" SHPK
NUIS: M22507403B
ADRESA: FIER, FSHATI GRYKE,
PASURIA 558, Z.K 3358

VENDIM NR. 2
DATË 19/03/2024
I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË "PARISOL" SHPK

Sot, më datë 19.03.2024, ora 12:00, në selinë e shoqërisë "Parisol" shpk, në adresën: Fier, Njësia Administrative Topojë, Fshati Gryke, Pasuria 558, Zona Kadastrale 3358, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "Parisol" shpk, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS M22507403B. Në këtë mbledhje janë të pranishëm personalisht ortakët e shoqërisë, si në vijim:

- **Z. Miken Dervishi**, i cili zotëron 90 % të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk;
- Shoqëria "**Albanian General Electricity**" sha, me NUIS L41706021V, e cila zotëron 10% të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk, përfaqësuar nga Aksionari i vetëm i saj **z. Besar Llapashtica**.

Në bazë të nenit 86 dhe 87 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, mbledhja konsiderohet e rregullt.

Rendi i ditës në mbledhjen e sotme është si më poshtë:

1. Miratimi i shitjes së 20% të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk, që zotërohet nga z. Miken Dervishi, në favor të shoqërisë "Aksent L&BC" shpk me NUIS L91406014L, me çmimin prej 223,112 Lekë (*dyqind e njëzetë e tre mijë e njëqind e dymbëdhjetë*).
2. Autorizimi i Administratorit të shoqërisë "Parisol" shpk, z. Ermal Dizdari, të kryejë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, veprimet e nevojshme procedurale për regjistrimin e kësaj kontrate në regjistrin tregtar.
3. Të ndryshme.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, pasi diskutoi çështjet e rendit të ditës, me unanimitet:

VENDOSI:

1. Miratimin e shitjes së 20% të kapitalit të shoqërisë "Parisol" shpk, që zotërohet nga z. Miken Dervishi, në favor të shoqërisë "Aksent L&BC" shpk me NUIS L91406014L, me çmimin prej 223,112 Lekë (*dyqind e njëzetë e tre mijë e njëqind e dymbëdhjetë*).



2. Autorizimi i Administratorit të shoqërisë “Parisol” shpk, z. Ermal Dizdari, të kryejë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, veprimet e nevojshme procedurale për regjistrimin e kësaj kontrate në regjistrin tregtar.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE
SHOQËRIA “PARISOL” SHPK
ORTAKËT**

Shoqëria “Albanian General Electricity” sha
Përfaqësuar nga Aksionari i vetëm
Z. Besar LLAPASHTICA

Besar Llapashtica



Z. Miken DERVISHI

MIKEN DERVISHI